



A.K.P.A.
 Nr. 2344 Prot.
 Datë, më 23 09 2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË

Tiranë, më 19/09/2024

Nr. 377 Prot

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit Nr 14, datë 27. 05. 2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar me Udhëzimin Nr 14, datë 27.05.2023 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Udhëzimin Nr 14, datë 27.05.2021, " Për mënyren e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, perberjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1 (një) Mësimdhënës i formimit teori –praktik për drejtimin "Hoteleri –Turizëm"Kuzhinë (Kohë e plotë)

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

3. Kriteret të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teori-praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë diplomë te nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
- d) preferohet të kete njohuri të ghuhes Angleze

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.
2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës30.09.2024

